



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 701 /2022  
Data: 03.02.2022

PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e parë -I- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 18.01.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetari i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtorja për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2022.
2. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021-2022.
3. Caktimi i kriterëve për shpalljen e konkursit për tri komitetet konsultative të komunës së Hanit të Elezit.
4. Themelimi i panelit (ad hok) përzgjedhës të anëtarëve të komiteteve konsultative në komunën e Hanit të Elezit.
5. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2021.
6. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- përveç pikave të cilat janë dërguar përmes agjendës kërkojë që të në rend të punës të procedohet edhe një pikë shtesë, formimi i komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale për mbeturina. Për pikën shtesë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

**Procedojmë me këtë rend të punës:-**

1. **Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2022.**
2. **Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021-2022.**
3. **Caktimi i kritereve për shpalljen e konkursit për tri komitetet konsultative të komunës së Hanit të Elezit.**
4. **Themelimi i panelit (ad hok) përzgjedhës të anëtarëve të komiteteve konsultative në komunën e Hanit të Elezit.**
5. **Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2021.**
6. **Formimi i komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale për mbeturina.**
7. **Të ndryshme.**

1. **Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2022.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevdi Dernjani thekson:-** te objektivat e planit të punës së kryetarit të komunës duhet të hiqet , Shënimi i 21 vjetorit të rënies së dëshmorëve Izet Bushi dhe dëshmorëve të Krivenikut (Ilaz Thaçit dhe Baki Krasniqit) dhe shënim i festave komunale dhe shtetërore me aktivitete të ndryshme sportive dhe kulturore, dhe te plani i prokurimit duhet të jetë emri i shefit të zyrës së prokurimit Xhevdet Bushi e jo i zyrtarit të prokurimit Avdush Bajramaliu . Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi thekson:-** a keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PLANI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

2. **Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021-2022.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

3. **Caktimi i kritereve për shpalljen e konkursit për tri komitetet konsultative të komunës së Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nora Xhoni thekson:-** te caktimi i kritereve është paraparë që të jetë edhe diploma, për çfarë diplome bëhet fjalë dhe është mirë që kur të bëhet përzgjedhja të përzgjedhjen profesionistë të lamive përkatëse.

**Kryesuesi thekson:-**sa i përket diplomës bëhet fjalë për diplomë të shkollës së mesme , universitare që i përshtatet komitetit për të cilin shpallet konkursi. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA CAKTIMI I KRITEREVE PËR SHPALLJEN E KONKURIST PËR TRI KOMITETE KONUSLTATIVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### 4. Themelimi i panelit (ad hok) përzgjedhës të anëtarëve të komiteteve konsultative në komunën e Hanit të Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- sipas udhëzimit administrativ komisioni duhet të ketë përbërje prej pesë anëtarëve dhe atë një anëtarë nga ekzekutivi i komunës, një anëtarë prej shoqërisë civile dhe tre anëtarë nga subjektet politike që do të thotë se një subjekt mbetet pa anëtarë të komisionit por nuk do të thotë që mbetet pa përfaqësim në këtë komitet. Komisionin duhet ta zgjedhim sipas udhëzimit dhe të dakordohemi se cili subjekt nuk donë me pasur anëtarë në komision. Mund të shkohet edhe me numër të votave të subjekteve politike të cilat ia kanë marr në zgjedhje e në këtë rast mund të mbetet pa përfaqësim Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e cila ka vota më së paku nga partitë e tjera, mirëpo subjekti politik i cili mbetet pa përfaqësim në komision i garantoj që do të ketë përfaqësim në këto komitete. Për mbledhje të kuvendit të komunës është mirë që t'i propozoni emrat. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA THEMELIMI I PANELIT AD HOK PËRZGJEDHËS TË ANËTARËRVE TË KOMITETEVE KONSULTATIVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### 5. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2021.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- te qendra e regjistrimit të bizneseve kemi pasur 201 subjektet tatim paguese, kurse aplikime për regjistrime të reja gjatë viti 2021 kemi pasur 33 kërkesa. Virusi ka ndikuar edhe në shuarje të bizneseve në komunë dhe kemi pasur 3 veprimtari të bizneseve të cilat janë shuar. Kërkesa kemi pasur më shumë për biznese të reja që në total i kemi pasur 49. Të hyra të cilat janë inkasuar për vitin 2021 prej drejtor janë në shumë prej 75 783.89 €, ndërsa nëse krahasohen me vitin paraprakë të hyrat për vitin 2020 ishin në shumë prej 59 349.99 €, që do të thotë ka pasur një ngritje në përqindje prej 27.7 %. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA INFORMATA MBI VEPRIMTARITË E SUBJEKTEVE AFARISTE PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### 6. Formimi i komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale për mbeturina.

**Kryesuesi** thekson:- komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale për mbeturina i ka skaduar mandati pasi që dy nga anëtarët ishin nga kuvendi komunës dhe tani nuk janë për shkak se nuk kanë garuar në zgjedhje, andaj duhet që të kemi në komision me përbërje tjetër i cili duhet të jetë dy anëtarë të kuvendit të komunës dhe një nga ekzekutivi. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.


#### 7. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në ora 11:19

**Procesmbajtësi**

**Ayni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**

**Florim Shkreta**

